



Pranuar / Doretuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM SHCK	8605/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1061/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtar, me Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1061/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar përmes formës elektronike në adresën zyrtare ankesa.kpmschck@rks-gov.net nga ankuesja

kundër organit të punësimit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike ‘*ndërrprerje e marrëdhënies së punës*’, duke vepruar në pajtim me nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.12.2022, mori këtë;

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent për të vendosur* për ankesën me numër A.nr.1061/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja ka qenë e punësuar sipas Kontratës së punës për shërbime konsulentë me numër protokollit 2840 të datës 19.08.2022 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta (konsulent individ) Inspektor teknik për nevojat e AZHB-së në me numër tw prokurimit: 203-22-5871-2-2-1 dhe me numër tw brendshëm 203/22/007/me afat të caktuar deri me datën 18.08.2023. Tutje ankuesja e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në pozitën inspektore teknike për nevojat e AZHB-së me deklaratën e datës 28.09.2022 njofton Menaxherin e kontratës z.Q.M për përkeqësimin e gjendjes shëndetësore dhe njëkohësisht për mos paraqitjen në vendin e punës.

Ndërsa me vendimin me numër reference 18/22 të datës 07.11.2022 të Zv. Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit dhe Sekretarit tw Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ankueses shkëputet kontrata e punës me numër protokollit 2840 të datës 19.08.2022.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 25.11.2022 ka parashtruar ankesën A.nr.1061/2022 me numër protokollit 7442/2022 në Këshillin e Pavarur



Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor të shkeljes të dispozitave ligjore me nxjerrejen e vendimit të MBPZHR me numër reference 18/22 të datës 07.11.2022 për shkëputjen e kontratës të lartëcekur.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa përgjigjen në ankesë ka pranuar me datë 14.12.2022 me shkresat e bashkangjitura për çështjen juridike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova : Ankesën e dërguar nga ankuesja me e-mail në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të protokolluar me numër 7442/2022 të datës 25.11.2022; Raportin nga Spitali "Fati Im" të datës 30.08.2022; Raportin nga QKUK të datës 14.09.2022; Raportin nga Spitali "Acibadem Sistina" të datës 19.09.2022; Deklaratën e ankueses të datës 28.09.2022; Vendimin për shkëputjen e kontratës të lëshuar nga MBPZHR me numër Ref.18/22 të datës 07.11.2022; Kontratën e lidhur mes MBPZHR dhe ankueses M.K me numër protokoll 2840 të datës 19.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë nga KSHMPCK-ja për MBPZHR me numër protokoll 7662/2022 të datës 05.12.2022; Përgjigjen në ankesë nga MBPZHR me numër protokoll 8075/2022 të datës 14.12.2022; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.80/2022 me numër protokoll 800/2022 të datës 15.02.2022; Ankesën në KSHMPCK me numër protokoll 18/2020 të datës 06.01.2020; Vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me numër protokoll 599/2019 të datës 07.10.2019; Njoftimin me numër protokoll 706/19 të datës 23.07.2019; Vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me nr.612/2019 të datës 26.06.2019; Njoftimin me e-mail lidhur me pranimin e ankesës në KSHMPCK të datës 25.11.2022; Vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.1082/2021 me numër protokoll 535/2022 të datës 04.02.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja . **sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se ankuesja marrëdhënien punës e ka themeluar, sipas Kontratës së punës për shërbime konsulentë me numër protokoll 2840 të datës 19.08.2022 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht më Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta (konsulent individ) Inspektor teknik për nevojat e AZHB-së në regjionin e Gjilanit në me numër tw prokurimit: 203-22-5871-2-2-1 dhe me numër tw brendshëm 203/22/007/me afat të caktuar deri me datën 18.08.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën e datës 25.11.2022 të ankueses sepse ankuesja ka qenë e angazhuar në pozitën **"Konsulent-individë, Inspektor Teknik për nevojat e AZHB-së në regjionin e Gjilanit"**, sipas Kontratës së punës me numër protokoll 2840 të datës 19.09.2022, për ofrimin e shërbimeve konsulente të lidhur me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe ankueses me numër tw prokurimit: 203-22-5871-2-2-1 dhe me numër tw brendshëm 203/22/007/me afat të caktuar deri me datën 18.08.2023, dhe rrjedhimisht në rastin konkret ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil, ashtu siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik, ku është përcaktuar se: **"Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në**




agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë . Duke u bazuar ne faktet e lartcekura, Kolegji vlerëson së pozita "Konsulent individë, Inspektor teknik për nevojat e AZHB-së në regjionin Gjilanit " nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil, andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo të kandidatit për pranim në shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1061 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesja

Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.Nr.1061/2022


Zyle Millaku-GOJNOVCI
Procesmbajtëse




Malsore GASHI-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

